



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1571/15 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

VENDIM

Nr.253, datë 29.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 195, DATË 26.09.2017,**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 195, datë 26.09.2017, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 1571/1 prot., datë 07.09.2017”.

KONSTATOVA SE:

Në datën 04.09.2017, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar kërkesa me nr 1571 prot., e nëpunësit *****, me detyrë Ekspert Mjeko-Ligjor pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, përmes së cilës pretendohet se ndaj tij është marrë masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, në shkelje flagrante të ligjit. Komisioneri për këtë rast ka filluar hetimin administrativ, gjatë të cilit ka shqyrtuar dhe administruar gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 195, datë 26.09.2017, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 1571/1 prot., datë 07.09.2017”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, aktin nr. 4437/8 prot, datë 28.07.2017, “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”.

2. Të kërkoj nga Komisioni i Disiplinës pranë Ministrisë së Drejtësisë, që me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, Vendimin përfundimtar nr.4437/22, datë 16.08.2017, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për punonjës in *****.

3. Të kërkojë nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, të rikthejë në detyrën e mëparshme punonjës in *****, duke i paguar pagën me të gjitha komponentët e saj, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare në datën 16.08.2017, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 195, datë 26.09.2017, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 1571/1 prot., datë 07.09.2017”, me shkresën nr. 1835 prot., datë 30.11.2017, dhe me shkresën nr. 1835/1 prot., datë 30.11.2017, “Mbi zbatimin e Vendimit Nr. 195, datë 26.09.2017, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 1571/1 prot., datë 07.09.2017””, drejtuar respektivisht Ministrisë së Drejtësisë dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore, ka filluar verifikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Enkelejda Hebibasi, Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Joni Marko, Specialist pranë kësaj drejtorie, të cilët në datën 01.12.2017, u paraqitën në insitucionin e Ministrisë së Drejtësisë.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin paralajmëruar. Dokumentacioni shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 01.12.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në **pikën 1 dhe 2 të vendimit** paralajmëruar, Komisioneri ka kërkuar respektivisht nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Komisioni i Disiplinës i Ministrisë së Drejtësisë të konstatojnë si akte administrative absolutisht të pavlefshme, aktin nr. 4437/8 prot., datë 28.02.2017, “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore” dhe aktin nr. 4437/22 prot., datë 16.08.2017, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për punonjës in *****.

Nga komunikimi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore rezultoi se, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Komisionit të Disiplinës pranë Ministrisë së

Drejtësisë nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të pikave 1 dhe 2 të vendimit të Komisionerit, fakt ky i përmendur edhe në procesverbalin e nënshkruar ndërmjet grupit të punës të Komisionerit dhe njësisë së burimeve njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë.

Siç është argumentuar edhe në Vendimin paralajmërues Nr. 195, datë 26.09.2017, të Komisionerit, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcakton qartë se kur një akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm, cilat janë pasojat e pavlefshmërisë së tij dhe detyrimin e organit publik për ta konstatuar atë nëse vjen në dijeni. Konkretisht, neni 111 i këtij ligji parashikon sa vijon:

“Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi.”

Sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm dhe Komisioni i Disiplinës pranë Ministrisë së Drejtësisë duhet të bëjnë kujdes që në të ardhmen të zbatojnë me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Në **pikën 3 të vendimit** paralajmërues të Komisionerit, i është kërkuar Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, të rikthejë në detyrën e mëparshme punonjësin *****, duke i paguar pagën që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare.

Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, *****, i larguar nga detyra si pasojë e Vendimit Nr. 4052/8, datë 28.06.2017, të Komisionit Disiplinor “Për marrjen e masës disiplinore ‘Largim nga shërbimi civil’”, marrë ndaj tij, në zbatim të Vendimit Nr. 3462 (80-2017-3334), datë 13.09.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në dispozitivin e të cilit është vendosur: **1. Pranimi i padisë së paditësit *****; 2. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 4052/8, datë 28.06.2017, të KD; 3. Detyrimi i palës së paditur (Ministrisë së Drejtësisë) për të rregulluar pasojat e krijuara nga akti i mësipërm ...; 4. Detyrimi i palës së paditur për rikthimin në pozicionin e mëparshëm si Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore...; 5. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm...**, është rikthyer në detyrë.

Me Vendimin nr. 2084 prot., datë 26.09.2017, Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore ka vendosur rikthimin në detyrën e mëparshme të nëpunësit *****. Në pikën dy të këtij vendimi është parashikuar se pagesa do të kryhet nga momenti i shkëputjes së marrëdhënies financiare më datë 16.08.2017, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit në pikën 3 të dispozitivit të vendimit objekt verifikimi.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 195, datë 26.09.2017, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 1571/1 prot., datë 07.09.2017”, të Komisionerit, rezulton se pasojat e ardhura nga aktet administrative absolutisht të pavlefshme konkretisht, akti nr. 4437/8 prot., datë 28.07.2017 dhe akti nr. 4437/22 prot., datë

16.08.2017, janë rregulluar me rikthimin në detyrë të nëpunësi ***** dhe përfitimin e pagesës nga momenti i shkëputjes së marrëdhënies financiare më datë 16.08.2017.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 195, datë 26.09.2017, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 1571/1 prot., datë 07.09.2017”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 195, datë 26.09.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Ministrisë së Drejtësisë, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha